



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kontrolli i Lartë i Shtetit

**RAPORT MONITORIMI
PËR STRATEGJINË E MENAXHIMIT TË
RISKUT TË KLSH PËR VITIN 2025**

Hyrje

Strategjia e Menaxhimit të Riskut, për Kontrollin e Lartë të Shtetit është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe i referohet planit të veprimit për përmbushjen e objektivave të vendosura në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027.

Në Strategjinë e Menaxhimit të Riskut, KLSH ka identifikuar risqet kryesore, të jashtme dhe të brendshme, risqet e menaxhimit institucional dhe risqe të punës audituese, mekanizmat e riskut si dhe kriteret për matjen e riskut, në përputhje me misionin e KLSH.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut është e bazuar në një sistem të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut, të nevojshëm për të maksimizuar burimet në dispozicion me qëllim përmbushjen e objektivave dhe maksimizimin e rezultateve të punës audituese nëpërmjet minimizimit të risqeve të brendshme dhe ato të jashtme.

Në këtë kuadër, strategjia e menaxhimit të riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt pengues për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Menaxhimi i riskut konsiderohet dhe vlerësohet si përgjegjësi e çdo punonjësi në KLSH, dhe përfshihet në të gjitha sistemet e menaxhimit dhe planifikimit të veprimtarisë institucionale. Në vijim, procesi i monitorimit paraqet vlerësimin e risqeve të identifikuara në nivel institucioni dhe në nivel departamenti apo strukture të vecantë. Kjo pasi veprimtaria e audituesit të jashtëm publik realizohet në kushte të një ndryshimi të vazhdueshëm të mjedisit të jashtëm por edhe të vetë audituesve të jashtëm publik.

Nëpërmjet analizës periodike në kuadër të këtij procesi monitorimi realizohet përditësimi i Regjistrit të Riskut, i cili përmban risqet e veprimtarisë audituese (ekonomike, sociale, teknologjike, ligjor/rregullatore dhe ambientale), risqet që lidhen me mbulimin e fushave të vlerësuara me risk më të lartë për auditimet e KLSH, në nivel departamenti. Pas përshkrimit të riskut është vlerësuar niveli i tij sipas klasave para dhe pas kontrollit, si dhe nevojat për kontrole të mëtejshme, duke përfshirë veprimet për të adresuar boshllëqet nga zotëruesi i riksut dhe ndryshimet në risk nga detyra e fundit.

Raporti i Monitorimit të Strategjisë së Riskut si një përmbledhje e analizës së situatës aktuale dhe progresit të bërë krahasuar me periudhën e mëparshme, vlerëson nëse po veprohet në linjë dhe drejt objektivave të caktuar duke ndihmuar në identifikimin e risqeve të reja, përcaktimin

e veprimeve të mëtejshme të cilat gjejnë pasqyrim në planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë.

Rezultatet e Monitorimit

Monitorimi është kryer si një proces periodik, i rregullt dhe sistematik dhe përfshin periudhën ushtrimore Janar-Dhjetor 2025. Anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Riskut, në funksion të implementimit të strategjisë kanë bashkërenduar veprimtarinë e tyre me Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive respektive në funksion të përmbushjes së përgjegjësive menaxheriale në të gjithë procesin e identifikimit, vlerësimit, monitorimit të riskut me qëllim kryesor përmbushjen e objektivave të Departamentit /Drejtorisë si dhe të objektivave institucionale. Në këtë kuadër janë përcaktuar dhe objektivat e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të Kontrollit të Lartë të Shtetit të cilat janë:

- Vijimi i ndërgjegjësimit për nevojën për menaxhimin e riskut;

Minimizimi i humbjeve, vjedhjeve, shkatërrimit dhe dëmtimit dhe ulja e kostove duke maksimizuar burimet;

Informimi i politikave dhe vendimmarrjes duke identifikuar risqet dhe ndikimin e tyre të mundshëm;

- Përmbushja e qëllimit dhe objektivave të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut realizohet nëpërmjet:

Vendosjes së roleve, përgjegjësive dhe linjave të raportimit brenda KLSH për menaxhimin e riskut;

Komunikim efektiv me dhe përfshirjen aktive të të gjithë stafit të çdo niveli, të udhëhequr nga drejtuesit;

Monitorimi i progresit të SMR dhe rishikimin e procesit të menaxhimit të rrezikut në vazhdimësi.

Evidentimi i risqeve dhe përditësimi i tyre është kryer duke përdorur analizën SËOT, ku:

Në *fuqitë* (Strength) cilësohen mandati kushtetues, pavarësia institucionale, vizioni, strategjia e zhvillimit, kuadri rregullativ, aksesit online, vënia e etikës si vlerë themelore etj.;

Në *dobësitë* (ëeakness) përfshihen vështirësitë në zbatimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAive) në kryerjen e auditimeve financiare dhe dhënin e një

opinionimi profesional për pasqyrat financiare, formulimi dhe afati i zbatimit të rekomandimeve, ndryshimet në kuadrin rregullator të auditimeve dhe vështirësitë në zbatimin e tyre praktik, mungesa e thellimit në qasjen në bazë risku, mangësi në funksionimin e të gjitha hallkave të kontrollit të cilësisë së auditimit, mungesa e qartësisë në raportimin e auditimit, përqendrimi i trajnimeve kryesisht në burimet e brendshme etj.;

Mundësitë (Opportunities) të cilat konsistojnë në mbështetjen e partnerëve rajonal e më gjerë, promovimi i stafit auditues, aktivizimi i ekspertëve të jashtëm, rritja e nivelit profesional nëpërmjet trajnimeve nga institucione homologe të përparuara të fushës etj.;

Ndërsa *kërcënimet (Threats)* kanë të bëjnë me perceptim dhe nganjëherë interpretim jo të drejtë të punës së KLSH nga subjektet e auditimit, palët e interesit, opinionimi publik, etj.; shkalla e pranimit dhe e zbatimit të rekomandimeve të KLSH; burime financiare dhe njerëzore të pamjaftueshme për të mbuluar me auditim të gjitha entet publike dhe në një kohë optimale, etj.

Në zbatim të strategjisë së riskut, **është përditësuar Regjistri i Riskut i përbërë nga Matrica e Risqeve Institucionale:** Politike/ Ekonomike/ Sociale/ Teknologjike/ Ligjore/ Rregullatore. Matricat përmbajnë të dhëna analitike për çdo risk të identifikuar duke përshkruar riskun, përcaktimin e nivelit të riskut para dhe pas kontrollit cilat janë kontrollet ekzistuese nivelet e vlerësuara për risqet e kontrolleve ekzistuese për çdo risk është përcaktuar nëse ka nevoja për kontrolle të mëtejshme, masat që do të ndërmerren për adresimin e boshllëqeve apo risqeve të reja, strukturën zotëruese të çdo risku dhe ndryshim e riskut nga statusi i fundit.

Një nga drejtimet e Menaxhimit të riskut është në funksion të **ruajtjes së aseteve të KLSH**, duke vendosur një sistem kontrolli efektiv për të garantuar mbrojtjen dhe parandalimin nga abuzimi dhe shpërdorimi i tyre. Për këtë qëllim, edhe gjatë vitit 2025, janë marrë masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin e aktiveve, ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, si dhe përdorimin e tyre në përputhje me qëllimin për të cilat janë alokuar, si:

- Wshhtë rinovuar kontrata e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë në të dy ambientet e KLSH-së.
- Janë kryer dhe rinovuar të gjitha kontratat e shërbimeve të rregullta të mirëmbajtjes së godinës për mbrojtjen nga zjarri, sistemi i kondicionimit, gjeneratorit, ashensorit, si dhe mjeteve të transportit për t'u siguruar se pajisjet punojnë me kapacitetet optimale dhe në pa ndërprerje.
- Wshhtë kryer inventarizimi periodik duke ngritur grupin e punës sipas kritereve ligjore, proces i cili u realizua në një kohë shumë më të shkurtër se një vit më parë.

-Janë zbatuar në çdo rast kërkesat e parashikuara në urdhrin nr. 59, datë 31.07.2023 “Për miratimin e dokumentit tip të urdhër shërbimit brenda dhe jashtë vendit”, urdhrit nr. 30, datë 20.03.2024 “Për miratimin e dokumentit tip të kërkesës për pajisje me bazë materiale”, si urdhrin nr. 137, datë 08.10.2018 ”Mbi respektimin e afateve kohore për dorëzimin e aktiveve nga punonjësit e KLSH-se në rast largimi nga puna” dhe urdhrit nr. 90, datë 10.11.2023 “Për miratimin e hartës së proceseve logjistike “Për fillimin dhe ndërprerën e punës në KLSH” në të cilin janë përcaktuar procedurat e detyrueshme dhe afatet për dorëzimin e aktiveve që këta punonjës kanë patur në përdorim.

-Është monitoruar nga afër identifikimi i nevojave për zëvendësimin e aktiveve të qëndrueshme të pajisjeve kompjuterike dhe automjeteve, duke vlerësuar veçmas dobishmërinë dhe jetëgjatësinë e përdorimit të çdo aktivi në konsideratë të normave ligjore të amortizimit, për të shmangur cenimin e vijimësisë së punës nga mosfunksionimi i papritur i aktivit.

-Për të gjitha shërbimet vjetore apo periodike janë ngritur grupet e punës përkatëse për monitorimin, verifikimin dhe marrjen në dorëzim përpara kryerjes së pagesave. Në çdo grup është siguruar pjesëmarrja e një punonjësi të fushës (IT, ing. Elektrik, mekanik, specialist komunikimi, etj.)

-Trajnimi i punonjësve për përdorimin dhe mbrojtjen e aktiveve, kryesisht sistemeve dhe softeve informatike IT, si dhe tërheqjen e vëmendjes me komunikime periodike për kujdesin dhe mirë përdorimin e tyre në vijimësi.

Në drejtim të menaxhimit të **risqeve financiare**, në lidhje me hartimin e një Projekt Buxheti të aftë për të përballuar nevojat financiare të KLSH për ushtrimin normal të veprimtarisë audituese, janë përpiluar kërkesat buxhetore në kohë dhe të argumentuara për nevojat reale të institucionit përtej tavanëve buxhetore të miratuara paraprakisht nga Ministria e Financave.

- Sipas rastit janë paraqitur edhe kërkesat për rialokime duke siguruar që fondet buxhetore të miratuara në ligjin e buxhetit të përdoren me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet.

- Janë ndjekur procedurat e prokurimit sipas parashikimeve të regjistrit të miratuar të prokurimeve me një realizim të investimeve me financim të brendshëm në masën 95 %. Kjo për shkak të faktorëve të jashtëm si: rritje të çmimeve të tregut, mos ofertim nga operatorët, zgjatje të procedurave për shkak të ankimit, apo vonesa në hartimin e specifikimeve teknike nga grupet e ngritura.

- Nga Sektori i financës janë përgatitur dhe paraqitur informacione periodike për realizimin dhe monitorimin e shpenzimeve operative, të pagave dhe ato të dietave brenda vendit

si një komponent i rëndësishëm në mbështetje të plotë të trupës audituese për realizimin e planit të auditimeve.

Në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, ka vijuar procesi i rekrutimit për plotësimin e organikës së miratuar. Janë kryer proceset e vlerësimit të performancës së punonjësve për 6-mujor në përputhje me ligjin e nëpunësit civil. Sa i takon strukturës organizative, gjatë vitit 2025 janë bërë ndryshimet përkatëse në funksion të organizimit më të drejtë të linjës hirarkike të raportimit, mbikëqyrjes në funksion të kontrollit të cilësisë por dhe të krijimit të ekspertizave të fushave të caktuara. Ndërkohë është vijuar me shpalljet e vendeve të lira edhe pse viti 2025 si një vit elektorale u ndikua nga kufizimi ligjor i parashikuar për punësimet në administratën publike.

Gjithashtu në lidhje me miradministrimin e informacionit dhe dosjeve personale, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është vijuar rregullisht me përdorimin e sistemit HRMIS dhe plotësimin me të dhëna historike.

Sa i takon **monitorimit të dokumenteve strategjik**, nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional gjatë vitit 2025 u hartuan:

- Plani i veprimtarisë audituese për vitin 2025 dhe në monitorimin e gjithë procesit të planifikimit vjetor të auditimeve, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 59, date 11.03.2025.
- Programi i Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, për vitin 2025 miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 18, date 21.01.2025.
- Në kuadër të Deklaratës së Angazhimit mes KLSH-së, dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI), është hartuar Regjistri i riskut të Cilësisë së Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 59, date 11.03.2025.
- Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2024, mbi implementimin e Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023-2027, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 87, date 15.05.2025.
- Një ndryshim në vendimin nr.166, datë 26.09.2023 “Për Miratimin e Metodologjisë së Planifikimit vjetor të auditimeve”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 94, date 04.06.2025.

- Udhëzues për përcaktimin e fushave me risk, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 212, date 21.10.2025.
- Në kuadër të Deklaratës së Angazhimit mes KLSH-së, dhe Inicativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI), është hartuar Harta e Proceseve për zbatimin e plotë të sistemit të menaxhimit të Cilësisë së auditimit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 246, date 30.12.2025.
- Në kuadër të Deklaratës së Angazhimit mes KLSH-së, dhe Inicativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI), është hartuar Udhëzuesit për Monitorimin dhe Përmirësimin, sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 247, date 30.12.2025.

Në lidhje me **auditimet e kryera nga Departamentet a Auditimit**, janë reflektuar në programet e auditimit kërkesat që burojnë nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në përputhje me llojin e auditimit, me risqet e identifikuara gjatë fazës së planifikimit apo buxhetin e subjektit të audituar, është janë mbajtur në konsideratë ndër të tjera historiku i borxhit si dhe standardet në fushën e raportimit financiar, janë reflektuar në programet e auditimit të gjithë drejtimit që adresojnë boshllëqet e identifikuara, borxhin publik dhe deficitin buxhetor por edhe problematika në lidhje me hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, detyrimet e prapambetura, detyrimet nga garancia shtetërore, etj.

Në lidhje me auditimet e kryera në funksion të përdorimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetet i fondeve dhe pasurisë publike, janë mbuluar fushat kryesore të vlerësuara sipas Udhëzuesit mbi përcaktimin e fushave me risk në financat publike por edhe sipas rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi në rezolutën vjetore.

Auditimet e teknologjisë së informacionit, janë mbështetur plotësisht në metodologjitë e njohura dhe miratuara të auditimit TI, si dhe audituesit kanë pasuruar njohuritë e tyre në këtë fushë nëpërmjet angazhimeve në auditime pilot me institucione. Gjithashtu kanë vijuar sipas programit të miratuar trajnimet në kuadër të bashkëpunimit me SAI-n e Norvegjisë.

Përgjatë vitit 2025, janë kryer trajnime të vazhdueshme në përputhje me nevojat e identifikuara të stafit auditues.

Rekomandimet për përmirësimin e gjendjes janë adresuar tek autoritetet përgjegjëse dhe në çdo rast është ndjekur zbatueshmëria e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Rezultatet e këtyre auditimeve janë reflektuar në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2024, si dhe do të jenë pjesë e Raportit të Aktivitetit të KLSH-së për vitin 2025.

Në lidhje me **komunikimin** ka vijuar intensivisht puna për të qenë më afër palëve të interesit. Me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 78, datë 22.04.2025 është zgjatur afati i Strategjisë së Komunikimit 2022-2025. Gjithashtu, është hartuar dhe miratuar Plani i Përditësuar i Veprimit për Strategjinë e Komunikimit me mbështetjen e ekspertëve të NAO-s, me shkresën nr. 475/3, datë 30.12.2025. Ka vijuar puna për rritjen e vizibilitetit të institucionit të KLSH-së dhe punës audituese si dhe për forcimin e kanaleve të komunikimit.

Marrëdhëniet me Kuvendin janë mbuluar dhe realizuar në mënyrë të vijueshme duke përcjellë informacione periodike drejt Kuvendit: Raporte Përfundimtare Auditimit dhe buletine informuese. KLSH ka marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta me Kuvendin, Komisionin për Ekonominë dhe Financat, si dhe Nënkomisionet Parlamentare, me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese. Është raportuar në Kuvend mbi Raportin e Performancës 2024 dhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit 2024.

Në lidhje me **detyrimet e rrjedhura nga ligji për të drejtën për informim**, në institucion janë caktuar me miratimin e Kryetarit të KLSH-së, koordinatori për të drejtën për informim dhe personi i kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale për monitorimin sipas kërkesave ligjore ka vijuar rregullisht publikimi i rezultateve të auditimit, trajtimi me korrektesë dhe përgjegjshmëri i letrave të popullit, botimet dhe rritja e prezencës së KLSH në media.

Në lidhje me **detyrimet e rrjedhura nga ligji për të drejtën për informim**, në institucion janë caktuar me miratimin e Kryetarit të KLSH-së, koordinatori për të drejtën për informim dhe personi i kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale për monitorimin sipas kërkesave ligjore ka vijuar rregullisht publikimi i rezultateve të auditimit, trajtimi me korrektesë dhe përgjegjshmëri i letrave të popullit, botimet dhe rritja e prezencës së KLSH në media.